



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me nenin 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/2010, 123/12, 43/14, 153/15, 6/ 16 dhe 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21) dhe neni 3, paragrafi 8 të Ligjit të Shërbimeve të Pagesave dhe të Sistemeve të Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 90 /22), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM

për mënyrën e njoftimit të shërbimeve bazuar në instrumentet pagesore që mund të përdoren vetëm në mënyrë të kufizuar dhe për transaksionet e pagesave që kryhen nëpërmjet një operatori të rrjeteve të komunikimit elektronik ose një ofruesi të shërbimeve të komunikimit elektronik, si dhe kriteret për vlerësimin e plotësimit sipas kushteve

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim parasheh:

- mënyrën e njoftimit në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore) nga lëshuesit e instrumenteve pagesore, duke përfshirë nëse paratë elektronike mbahen në këto instrumente pagesore, të cilat mund të përdoren vetëm në mënyrë të kufizuar (në vijim: pagesa në rrjet të kufizuar)
- mënyrën e njoftimit në Bankën Popullore nga operatori i rrjeteve të komunikimit elektronik ose ofruesi i shërbimeve të komunikimit elektronik për transaksionet e pagesave, duke përfshirë transaksionet e pagesave me para elektronike, të cilat kryhen nëpërmjet tyre, dhe për të cilat nuk zbatohen dispozitat e ligjit dhe
- kriteret për vlerësimin e plotësimit të kushteve të pagesës në një rrjet të kufizuar.

2. Shërbime të bazuara në instrumente pagesore për pagesë në rrjet të kufizuar konsiderohen shërbimet që mund të përdoren vetëm në mënyrë të kufizuar dhe që plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

- instrumentet pagesore i mundësojnë mbajtësit të përvetësojë mallra ose shërbime vetëm në hapësirat e lëshuesit ose në një rrjet të kufizuar ofruesish shërbimesh që kanë lidhur drejtpërdrejt marrëveshje tregtare me lëshuesit e instrumenteve;
- instrumentet pagesore mund të përdoren vetëm për përvetësimin në një fushë shumë të kufizuar për mallrat ose shërbimet.

3. Si transaksione pagesash, duke përfshirë transaksionet e pagesave me para elektronike, për të cilat nuk zbatohen dispozitat e Ligjit të Shërbimeve të Pagesave dhe të Sistemeve të Pagesave (në tekstin e mëtejshëm: ligji), konsiderohen pagesat e bëra nëpërmjet një operatori të rrjeteve të komunikimit elektronik ose një ofruesi të shërbimeve të komunikimit elektronik, i cili parapaguesit të rrjetit ose shërbimit i jepën shërbime plotësuese të komunikimit elektronik, pavarësisht nëse parapaguesi i rrjetit ose shërbimit ia paguan mjetet ofruesit të rrjetit ose shërbimit të komunikimit elektronik paraprakisht ose më pas, nëse shuma e transaksionit të pagesës individuale nuk i kalon 3.000 denarë ose ekuivalentin përkatës në valuta të tjera dhe shuma totale mujore e transaksioneve të pagesave të një parapaguesi individual nuk i kalon 18.000 denarë ose ekuivalentin përkatës në valuta të tjera:

- për blerjen e përmbajtjes digjitale dhe shërbimeve zanore, pavarësisht nga pajisja e përdorur për të blerë ose konsumuar përmbajtjen digjitale, të cilat tarifohen nëpërmjet dorëzimit të një faturë ose llogari të përshtatshme te parapaguesit, ose

- kryhen me ose nëpërmjet një pajisjeje elektronike, për qëllime bamirësie ose për blerjen e biletave të hyrjes dhe faturohen së bashku me shërbimet e komunikimit elektronik nëpërmjet dorëzimit të një faturë ose llogari të përshtatshme te parapaguesi.

II. MËNYRA E NJOFTIMIT

4. Lëshuesi i instrumenteve pagesore i cili ka për qëllim të lëshojë instrument pagesor, sipas pikës 2 të këtij vendimi, në vlerë më të madhe se 60 milionë denarë, gjatë një viti kalendarik, është i obliguar të dorëzojë njoftim në Bankën Popullore me përshkrimin e shërbimeve të ofruara, nëse mallrat dhe shërbimet që mund të blihen me atë instrument pagesor janë nga një vendndodhje fizike apo digjitale dhe një shpjegim për plotësimin e kushtit përkatës të përjashtimit që zbatohet për këto shërbime sipas pikës 10 dhe 11 të këtij vendimi.

Njoftimi, sipas paragrafit 1 të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe shpjegimin nëse instrumenti pagesor që synon të lëshojë nuk e vendos atë në pozitë më të favorshme se ofruesit e tjerë të shërbimeve pagesore.

Njoftimi, sipas paragrafit 1 të kësaj pike, bëhet me paraqitjen e formularit nr. 1- Të dhëna për lëshuesin e instrumenteve pagesore.

5. Lëshuesi i instrumenteve pagesore të përmendura në pikën 4 të këtij vendimi, pasi të ketë lëshuar instrumentet pagesore në baza të rregullta vjetore, dhe jo më vonë se fundi i tremujorit të parë të vitit aktual, është i detyruar të njoftojë Bankën Popullore për vlera totale e transaksioneve të pagesave të kryera gjatë 12 muajve të mëparshëm.

6. Lëshuesi i instrumenteve pagesore i cili tashmë ka dorëzuar njoftimin për lëshimin e instrumenteve pagesore, sipas pikës 2 të këtij vendimi, e njofton Bankën Popullore nëse në të dhënat e dorëzuara ndodhin ndryshime të mëdha, si p.sh.

- rritja e numrit të hapësirave apo pikave të shitjes së lëshuesit brenda rrjetit të kufizuar të ofruesve të shërbimeve;
- ndryshimi ose rritja e fushës gjeografike ku mund të përdoren këto instrumente;

- lëshimi i një lloji të ri instrumentesh të ndryshme nga ato për të cilat është dorëzuar njoftimi;
- ndryshimi i fushës së mallrave dhe të shërbimeve për të cilat mund të përdoren instrumentet.

7. Në bazë të njoftimit, sipas pikës 4 të këtij vendimi, dhe në bazë të kritereve të përcaktuara në pikat 10 dhe 11 të këtij vendimi, Banka Popullore vlerëson plotësimin e kushteve për kufizimin e rrjetit, sipas pikës 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1. 1 të këtij vendimi, ose kufizimi i fushës së veprimit të mallrave ose shërbimeve, sipas pikës 2, paragrafi, nënparagrafi 2 të këtij vendimi.

8. Banka Popullore, në afat prej 90 ditësh nga marrja e njoftimit, sipas pikës 4 të këtij vendimi, njofton lëshuesin e instrumenteve pagesore se:

- mund të fillojë ose të vazhdojë lëshimin e instrumenteve pagesore ose
- të paraqesë kërkesë për licencë për ofrimin e shërbimeve të pagesave në përputhje me ligjin, në afat jo më të gjatë se 180 ditë, nëse konstatohet se instrumentet pagesore nuk i plotësojnë kushtet për përjashtim, sipas pikës 10 dhe 11 të këtij vendimi.

9. Operatori i rrjeteve të komunikimit elektronik ose ofruesi i shërbimeve të komunikimit elektronik, i cili synon të kryejë transaksione pagese, përfshirë transaksionet e pagesave me para elektronike në shumat e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi i, është i detyruar përpara se të fillojë të ofrojë shërbimet sipas pikës 3 të këtij vendimi, ndërsa më së voni deri në fund të gjysmë vitit aktual të dorëzojë të Banka Popullore:

- dëshmi nga organi kompetent se është i autorizuar për kryerjen e shërbimeve si operator i rrjeteve të komunikimit elektronik/ofrues i shërbimeve të komunikimit elektronik;
- Formulari i plotësuar nr. 2- Të dhëna për operatorin e rrjeteve të komunikimit elektronik/ofruesin e shërbimeve të komunikimit elektronik dhe
- mendim nga një auditor i pavarur që konfirmon se në vitin paraprak është plotësuar kushti për përjashtim i përcaktuar në pikën 1 të pikës 3 të këtij vendimi.

III. KRITERET QË DUHET PLOTËSUAR PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE BAZUARA NË INSTRUMENTE PAGESORE, PËRFSHIRË EDHE NËSE KËTO INSTRUMENTE RUAJNË PARA ELEKTRONIKE, TË CILAT MUND TË PËRDOREN VETËM NË MËNYRË TË KUFIZUAR

10. Për t'u konsideruar se lëshuesit e instrumenteve pagesore mundësojnë pagesa në një rrjet të kufizuar vetëm në hapësirat e lëshuesit ose në një rrjet të kufizuar ofruesit të shërbimeve, duhet të plotësohen kriteret e mëposhtme:

- është lidhur një marrëveshje e drejtpërdrejtë tregtare për pranimin e transaksioneve të pagesave ndërmjet lëshuesve të instrumenteve pagesore dhe ofruesve të mallrave dhe shërbimeve në rrjetin e kufizuar;
- parashikohet numri maksimal i hapësirave ose i pikave të shitjes së lëshuesit brenda rrjetit të kufizuar të ofruesve të shërbimeve;

- ofruesi i shërbimit ofron produkte dhe shërbime nën një markë të përbashkët që është karakteristikë e një rrjeti të kufizuar dhe ofron një shfaqje vizuale për përdoruesit e instrumentit pagesor;
- është përcaktuar fusha gjeografike për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve;
- janë parashikuar vëllimi dhe vlera e transaksioneve të pagesave që do të kryhen me instrumentet pagesore në baza vjetore;
- parashihet shuma maksimale që do të kreditohet në instrumentet pagesore;
- parashihet numri maksimal i instrumenteve pagesore që do të lëshohen dhe
- lëshuesi i instrumentit pagesor ka identifikuar rreziqet me të cilat mund të përballlet paguesi kur përdor një instrument të caktuar pagesor.

11. Në mënyrë që lëshuesi i instrumenteve pagesore të konsiderohen se mundësojnë pagesa në një rrjet të kufizuar vetëm për blerjen e një sferë shumë të kufizuar të mallrave ose shërbimeve, duhet të plotësohen kriteret e mëposhtme:

- janë parashikuar vëllimi dhe vlera e transaksioneve të pagesave që do të kryhen me instrumentet pagesore në baza vjetore.
- parashikohet shuma maksimale që do të kreditohet në instrumentet pagesore;
- është parashikuar numri maksimal i instrumenteve pagesore që do të lëshohen;
- lëshuesi i instrumentit pagesor ka identifikuar rreziqet me të cilat mund të përballlet paguesi kur përdor një instrument të caktuar pagesor dhe
- lëshuesi e ka identifikuar lidhjen e ndërsjellë funksionale të mallrave dhe/ose shërbimeve që mund të blihen me instrumentin e caktuar pagesor.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

12. Personat juridikë, të cilët me datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi kanë lëshuar instrumentin pagesor sipas pikës 2 paragrafi 1, nënparagrafi 1 dhe 2 të këtij vendimi, në vlerë mbi 60 milionë denarë në vitin paraprak kalendarik, janë të obliguar më së voni deri më 15 shkurt 2023 të dorëzojnë njoftim në Bankën Popullore, në përputhje me pikën 4 të këtij vendimi.

Operatori i rrjeteve të komunikimit elektronik ose ofruesi i shërbimeve të komunikimit elektronik, i cili në datën e fillimit të zbatimit të këtij vendimi mundëson tashmë kryerjen e transaksioneve të pagesave, përfshirë transaksionet e pagesave me para elektronike, sipas pikës 3 të këtij vendimi, janë të detyruar të njoftojnë Bankën Popullore në afat prej 12 muajsh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij vendimi në mënyrën e përcaktuar në pikën 9 të këtij vendimi.

13. Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e tetë nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut,

O nr. 02-15/XXII-4/2022

**28 dhjetor 2022
Shkup**

**Guvernatorja dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së
Veriut
Dr. Anita Angellovska - Bezhoska**

Formulari nr.1 – Të dhënat për lëshuesit e instrumenteve pagesore

1.1 Titulli i plotë i lëshuesit të instrumentit pagesor:

1.2 Selia e lëshuesit të instrumentit pagesor:

1.3 Numri i amzës i subjektit dhe numri tatimor:

1.4 Vallë lëshuesi paraprak i instrumentit pagesor ka parashtruar njoftim te Banka Popullore për kryerjen e shërbime në bazë të instrumentit pagesor të cilat mund t'i përdorin vetëm në mënyrë të kufizuar?

Nëse përgjigja është pohuese, shënoni të dhënat e detajuara.

2. Vlera e transaksionit

Shënoni informacione për vlerën e përgjithshme të transaksionit pagesor të cilat janë të planifikuara të realizohen gjatë 12 mujve të cilat llogariten si shërbime mbi bazë të instrumenteve pagesore, duke përfshirë edhe nëse këto instrumentet pagesore ruhen në para elektronike, të cilat mund të përdoren në mënyrë të kufizimit.

2.1 Informacionet kanë të bëjnë me datën e fillimit, datën e përfundimit dhe vlerën e transaksionit.

Periudha:

Data e fillimit

Data e fundit

Data e fundit

Vlera e transaksionit (në denarë)

3. **Përshkrimi i shërbimeve të ofruara dhe sqarimi i plotësimit të kushtit përkatës për përjashtim që zbatohet në këto shërbime.**

- 3.1 **Sa produkte të ofruara nga lëshuesi i instrumentit pagesor llogaritet se i ka plotësuar kushtet për kryerjen e shërbime në bazë të instrumenteve pagesore, duke përfshirë edhe nëse këto instrumente pagesore ruhen në para elektronike, të cilat mund të përdoren në mënyrë të kufizuar?**

- 3.2 **Shënoni detaje për çdo produkt/shërbim individual që konsiderohet të përdoret vetëm në një mënyrë të kufizuar.**

Produkti/Shërbimi 1

Emri i produktit/shërbimit që është i njohur nga publiku i gjerë dhe pagesi

Zgjidh

**Zgjidhni nga lista e instrumenteve cili është më i përshtatshëm për instrumentin e lëshuar?
Nëse përgjigja është pohuese, jepni të dhëna të detajuara.**

Shënoni një përshkrim të shkurtër të shërbimit mbi bazë të instrumentit pasor të lëshuar (p.sh. kartë pripejt gift për blerjen e biletave për kinema)

Zgjidh nëse produkti/shërbimi individual plotëson kushtet e kufizimit të rrjetit ose kushtet e kufizimit të fushës së mallrave ose shërbimeve

Zgjidh

Shënoni të dhëna të detajuara për shërbimet e bazuara në instrumentet e pagesave, duke përfshirë nëse paratë elektronike ruhen në këto instrumente pagese, edhe atë për:

- llojin e instrumentit pagesor;
- ku dhe si mund të përdoret instrumenti pagesor;
- ku ndodhen klientët ose përdoruesit;
- roli i lëshuesit të instrumentit pagesor në fluksin e mjeteve (nëse ka) p.sh. në cilën pikë lëshuesi i instrumentit pagesor i ka mjetet në posedim, nga ku merren mjetet dhe ku transferohen mjetet;
- si përvetësohen (gjenerohen) transaksionet;
- tregtarë që pranojnë pagesa për mallra dhe shërbime nëpërmjet instrumentit pagesor dhe marrëdhënies kontraktuale ndërmjet lëshuesit të instrumentit pagesor dhe tregtarit;
- llojin e mallrave dhe/ose shërbimeve që mund të blihen duke përdorur instrumentin pagesor;
- çdo kufizim në përdorimin e instrumentit pagesor (dhe si vendoset ky kufizim, p.sh. nëpërmjet funksionalitetit teknik të instrumentit pagesor ose nëpërmjet kushteve të bashkëngjitura në instrumentin pagesor) dhe
- çdo karakteristikë tjetër të instrumentit pagesor që është e rëndësishme për kufizimin e rrjetit ose për kufizimin e fushës së mallrave ose të shërbimeve.

Produkti/Shërbimi 2

Emri i produktit/shërbimit që është i njohur nga publiku i gjerë dhe pagesi

Zgjidhni nga lista e instrumenteve, cili është më i përshtatshëm për instrumentin e lëshuar?

Nëse përgjigja është pohuese, jepni të dhëna të detajuara.

Zgjidh

Shënoni një përshkrim të shkurtër të shërbimit mbi bazë të instrumentit pasor të lëshuar (p.sh. kartë pripejt gift për blerjen e biletave për kinema)

Zgjidh nëse produkti/shërbimi individual plotëson kushtet e kufizimit të rrjetit ose kushtet e kufizimit të fushës së mallrave ose shërbimeve

Zgjidh

Shënoni të dhëna të detajuara për shërbimet e bazuara në instrumentet e pagesave, duke përfshirë nëse paratë elektronike ruhen në këto instrumente pagese, siç vijon:

- llojin e instrumentit pagesor;
- ku dhe si mund të përdoret instrumenti pagesor;
- ku ndodhen klientët ose përdoruesit;
- roli i lëshuesit të instrumentit pagesor në fluksin e mjeteve (nëse ka) p.sh. në cilën pikë lëshuesi i instrumentit pagesor i ka mjetet në posedim, nga ku merren mjetet dhe ku transferohen mjetet;
- si përvetësohen (gjenerohen) transaksionet;
- tregtarë që pranojnë pagesa për mallra dhe shërbime nëpërmjet instrumentit pagesor dhe marrëdhënies kontraktuale ndërmjet lëshuesit të instrumentit pagesor dhe tregtarit;
- llojin e mallrave dhe/ose shërbimeve që mund të blihen duke përdorur instrumentin pagesor;
- çdo kufizim në përdorimin e instrumentit pagesor (dhe si vendoset ky kufizim, p.sh. nëpërmjet funksionalitetit teknik të instrumentit pagesor ose nëpërmjet kushteve të bashkëngjitura në instrumentin pagesor) dhe
- çdo karakteristikë tjetër të instrumentit pagesor që është e rëndësishme për kufizimin e rrjetit ose për kufizimin e fushës së mallrave ose të shërbimeve.

Nëse lëshuesi i instrumentit të siguruar më shumë se dy produkte/shërbime, kopjoni informacionet më lart dhe shtoni për secilin produkt më poshtë.

Vendi dhe data	Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës të lëshuesit të instrumentit pagesor
-----------------------	--

Formulari nr.2 – Të dhënat e operatorit të rrjetit të komunikimit elektronik /ofruesit të shërbimeve të komunikimeve elektronike

3.3 Titulli i plotë i operatorit të rrjetit të komunikimit elektronik /ofruesit të shërbimeve të komunikimeve elektronike:

3.4 Selia e operatorit të rrjetit të komunikimit elektronik /ofruesit të shërbimeve të komunikimeve elektronike:

3.5 Numri i amzës i subjektit dhe numri tatimor:

3.6 Operatori i rrjeteve të komunikimit elektronik/ofruesi i shërbimeve të komunikimit elektronik a ka dorëzuar më parë njoftim në Bankën Popullore për transaksione pagesash dhe transaksione pagesash me para elektronike?

Nëse përgjigja është pohuese, shënoni të dhënat e detajuara.

4. Përshkrimi i transaksioneve të pagesave të kryera nëpërmjet një operatori të rrjeteve të komunikimit elektronik/ofruesit të shërbimeve të komunikimit elektronik të rrjeteve të komunikimit elektronik

4.1 Nëse transaksionet e pagesave, duke përfshirë transaksionet e pagesave me para elektronike, janë për blerjen e përmbajtjes digjitale dhe shërbimeve zanore, pavarësisht nga pajisja e përdorur për blerjen ose konsumimin e përmbajtjes digjitale dhe tarifohen nëpërmjet dërgimit të një llogarie ose fature të përshtatshme te parapaguesi?

Nëse përgjigja është pohuese, shënoni të dhënat e detajuara për mallrat ose shërbimet:

Blerja e përmbajtjeve digjitale

Shërbimet zanore

2.2 Vallë transaksionet pagesore duke përfshirë edhe transaksionet pagesore me para elektronike janë të kryera me ose nëpërmjet pajisjeve elektronike, për qëllime humanitare ose për blerje të biletave hyrëse, ndërkaq paguhen së bashku me shërbimet komunikuese elektronike nëpërmjet dorëzimit të llogarisë përkatëse ose faturës deri te parapaguesi?

Zgjidh

Nëse përgjigja është pohuese, shënoni të dhënat e detajuara për mallrat ose shërbimet:

Qëllimet kontraktuale:

Biletat:

Vallë operatori i rrjetit të komunikimit elektronik/oferuesi i shërbimeve komunikuese elektronike ofron më shumë shërbime të tilla?

Zgjidh

2.3. Shënoni kushtet për plotësim të përjashtimit të Ligjit të Transaksioneve Pagesore duke i përfshirë edhe transaksionet pagesore me para elektronike.

2.4 Jepni shpejgim për vendosjen dhe monitorimin e kufizimit të shumës prej 3.000 denarë për transaksionet pagesore individuale dhe për shumën e përgjithshme mujore të transaksioneve pagesore prej 18.000 denarë për një parapagues individual.

Vendi dhe data

**Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i
personit përgjegjës të operatorit të
rrjeteve komunikuese elektronike**
